



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 6 Mars 2023

Nr: 94

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV NDAJ PERSONIT PËRGJEGJËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË,  
PËR RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E  
QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 6 Mars 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim çështjen administrative me:

**SUBJEKT:** Zj. Najada Samarxhi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Bankën e Shqipërisë

**OBJEKT:** Shqyrtim administrativ ndaj personit përgjegjës të Bankës së Shqipërisë, për raportimin e veprimtarive publike

**BAZA LIGJORE:** Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 65 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

**K O N S T A T O J :**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 21.1.2023 dhe datë 11.2.2023 në adresën e postës elektronike, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ka marrë indicie për organizimin e 3 (tre) veprimtarie publike nga ana e Bankës së Shqipërisë.

Data: 6 Mars 2023

Nr: 94

Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të Bankës së Shqipërisë, për raportimin e veprimtarive publike”

Indiciet janë marrë nëpërmjet provave ku pretendohet si në vijim:

1. "Banka e Shqipërisë, Ministria e Brendshme dhe Prokuroria e Përgjithshme kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për "Parandalimin e Falsifikimit të Monedhave". Denoncuesi pretendon se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator.  
[Link:https://www.bankofalbania.org/Shtypi/Njoftimet\\_per\\_shtyp/Nenshkruset\\_Marreve\\_shja\\_e\\_Bashkepunimit\\_Nderinstitucional\\_ne\\_fushen\\_e\\_mbrojtjes\\_se\\_monedhave\\_kund\\_er\\_falsifikimit.html](https://www.bankofalbania.org/Shtypi/Njoftimet_per_shtyp/Nenshkruset_Marreve_shja_e_Bashkepunimit_Nderinstitucional_ne_fushen_e_mbrojtjes_se_monedhave_kund_er_falsifikimit.html)  
Veprimtaria publike rezulton të jetë transmetuar në 3 (tre) media publike."
2. "Konferenca për shtyp e Guvernatorit Sejko mbi vendimmarrjen e politikës monetare 1 shkurt 2023".  
Denoncuesi pretendon se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator.  
<https://www.facebook.com/Bank.of.Albania/videos/515819534000390/>
3. "Organizohet Konferenca IV-t e Muzeut të Bankës së Shqipërisë "Mesjeta, pararendëse e një sistemi monetar të mirorganizuar".  
4. Denoncuesi pretendon se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator.  
[https://www.bankofalbania.org/Shtypi/Njoftimet\\_per\\_shtyp/Organizohet\\_Konferenca\\_I\\_Vt\\_e\\_Muzeut\\_te\\_Bankes\\_se\\_Shqiperise\\_Mesjeta\\_pararendese\\_e\\_nje\\_sistemi\\_monetar\\_te\\_mirorganizuar.html](https://www.bankofalbania.org/Shtypi/Njoftimet_per_shtyp/Organizohet_Konferenca_I_Vt_e_Muzeut_te_Bankes_se_Shqiperise_Mesjeta_pararendese_e_nje_sistemi_monetar_te_mirorganizuar.html)"

Neni 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n" e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, pasi u shqyrtua paraprakisht çështja, vlerësoj se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Meqenëse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë paraqitur 3 (tre) indicie nëpërmjet provave link të ndryshme, që i dejtohen të njëjtit subjekt, si dhe objekti i shqyrtimit bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore, në mbështetje të nenit 65, shkronja "ç" të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", u vendos shqyrtimi së bashku i këtyre indicieve.

Me çeljen e hetimit administrative, fillimisht, më datë 13.2.2023 dhe në vijim më datë 16.2.2023, Bankës së Shqipërisë i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike.

Më datë 3.3.2023, Banka e Shqipërisë, lidhur me 3 (tre) indiciet e marra bën me dije se: *“Banka e Shqipërisë nuk ka patur njoftim zyrtar se kur duhej të fillonte raportimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në shkresën zyrtare drejtuar institucioneve të pavarura të datës 11 Janar 2023, që keni publikuar në faqen tuaj të internetit, ju nuk e keni përfshirë Bankën e Shqipërisë dhe për rrjedhojë ne nuk kemi patur informacion për datën zyrtare të fillimit të raportimit. Pasi kemi marrë emailin tuaj të datës 13 Shkurt 2023, në faqen tuaj të internetit jemi njohur me faktin se data 13 Janar 2023, është data e fillimit të raportimit dhe kemi raportuar gjithë eventet që nga ajo datë më sot. Në vijim dëshiroj t’iu garantoj se zbatimi i raportimit do të ndiqet me rigorizitet nga ana e Bankës së Shqipërisë, gjatë gjithë periudhës së fushatës deri në datë 14 Maj 2023, njësoj sic kemi vepruar gjatë fushatës në vitin 2021.”*

Pas verifikimit të rrethanave dhe fakteve, vlerësohet se mungesa e informacionit si dhe problematikat me sistemin dhe pajisjen me kredencialet kanë ardhur për shkak të vështirësive në aksesimin e ndërfaqes së raportimeve dhe për shkaqe të tjera objektive jashtë vullnetit të organit publik.

Në këto kushte, duke qenë se qëllimi nuk ka qenë shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit, vlerësoj se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të pushohet hetimi administrativ për ato shkelje që lidhen me çështjen objekt shqyrtimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj Bankës së Shqipërisë, nuk përbën shkelje të nenit 92, Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

#### **V E N D O S:**

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj zj. Najada Samarxhi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në Bankën e Shqipërisë.
2. Moskonstatimin e shkeljes administrative.
3. Tërheqje vëmendje ndaj Bankës së Shqipërisë, për marrjen e masave të menjëhershme, për raportimin e veprimtarive publike.

Data: 6 Mars 2023

Nr: 94

Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të Bankës së Shqipërisë, për raportimin e veprimtarive publike”

4. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: 6 Mars 2023

Nr: 94  
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të Bankës së Shqipërisë, për raportimin e veprimtarive publike”